

U R D H Ë R
Nr.148, datë 20.4.1999

**PËR KUSHTET DHE NORMAT TEKNIKE QË DUHEN RESPEKTUAR NË
IMPIANTET DHE INSTALIMET E TREGTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 14, 15 e 16 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”

U R D H Ë R O J:

1. Për impiantet dhe instalimet që zotërohen nga subjektet, të cilat ushtrojnë aktualisht veprimtarinë e tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre (të përcaktuara në nenet 14, 15 e 16 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”), do të pranohen normat dhe kushtet teknike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Për impiantet dhe instalimet e reja që do të ndërtojnë subjektet juridike që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi në përputhje me kreun I dhe II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.129, datë 18.3.1999, si dhe për rikonstruksionet në impiantet e instalimet ekzistuese, do të zbatohen kushtet dhe normat teknike të pranuar nga vendet e Bashkimit Europian.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve, që brenda tremujorit të tretë të vitit 1999, të përcaktojë kushtet dhe normat teknike për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre (sipas neneve 14, 15 e 16 të ligjit) sipas normave të pranuar nga vendet e Bashkimit Europian.

4. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit e Nënprodukteve të tyre për kontrollin e kushteve e të normave teknike për subjektet që do të kërkojnë leje tregtimi ose autorizim.

Ky Inspektorat, pas verifikimit, i jep vërtetimin përkatës subjektit që ka paraqitur kërkesën.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Ylli Bufi